LIGJ
Nr. 34/2016

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS ÇEKE PËR MBROJTJEN SHOQËRORE

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Çeke për mbrojtjen shoqërore.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 24.3.2016

Shpallur me dekretin nr. 9506, datë 6.4.2016, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

MARRËVESHJE
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS ÇEKE PËR MBROJTJEN SHOQËRORE

Republika e Shqipërisë dhe Republika Çeke, në vijim të referuara si "Shtetet Kontraktuese",
duke pasur si qëllim rregullimin dhe zhvillimin e marrëdhënieve ndërmjet dy shteteve në fushën e mbrojtjes shoqërore,
kanë rënë dakord si më poshtë:

PJESA I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Përkufizime

1. Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:
a) "Legjislacion", ligje dhe rregullore të tjera kombëtare në lidhje me degët e mbrojtjes shoqërore të përcaktuara në nenin 2;
b) "Autoriteti kompetent", ministritë përgjegjëse për degët e mbrojtjes shoqërore të përcaktuara në nenin 2;
c) "Institucion", organi ose autoriteti përgjegjës për zbatimin e legjislacionit të përcaktuar në nenin 2;
d) "Institucioni kompetent", institucioni me shpenzimet e të cilit sigurohen përfitimet;

e) "Përfitime", të gjitha përfitimet e përcaktuara në nenin 2;

f) "Përfitime në natyrë", kujdesi shëndetësor dhe lloje të tjera përfitimesh jo në para në rast sëmundjeje;

g) "Vendbanim", vendbanimi i përhershëm;

h) "Qëndrim", vendbanimi i përkohshëm;

i) "Periudhat e sigurimit", periudhat e kontributit dhe periudhat e barasvlershme të përmbushura sipas legjislacionit të secilit shtet kontraktues.

2. Termat dhe shprehjet e tjera të përdorura në këtë Marrëveshje do të kenë kuptimin e përcaktuar për to në legjislacionin e secilit shtet kontraktues.

Neni 2

Fushëveprimi material

1. Kjo Marrëveshje zbatohet:

Për Republikën e Shqipërisë, me legjislacionin që rregullon:

a) Për sa i përket skemës së detyrueshme të sigurimeve shoqërore:

i) përfitimet në para për sëmundje për personat e punësuar;

ii) përfitimet në para për barrëlindje për personat e punësuar dhe të vetëpunësuar, si dhe për punëdhënësit;

iii) përfitimet në para për aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale për personat e punësuar;

iv) pensionet e pleqërisë, të invaliditetit dhe familjare për personat e punësuar dhe të vetëpunësuar, si dhe për punëdhënësit

b) Për sa i përket skemës së sigurimeve shëndetësore, përfitime në natyrë sipas sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor;

c) Detyrimi për pagesën e kontributeve të sigurimit shoqëror dhe shëndetësor, sipas legjislacionit të përcaktuar në përputhje me pjesën II.

Për Republikën Çeke, me legjislacionin që rregullon:

a) i) përfitimet për sëmundjet dhe barrëlindjet;

ii) përfitimet për sigurimin e pensionit të pleqërisë, invaliditetit dhe pensionit familjar;

iii) përfitimet për sëmundjet profesionale dhe aksidentet në punë,

b) Detyrimin për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore, politikën shtetërore të punësimit dhe kontributin e sigurimeve shëndetësore sipas legjislacionit të përcaktuar në përputhje me pjesën II;

2. Kjo Marrëveshje zbatohet edhe për kodifikimin, zëvendësimin, ndryshimin ose plotësimin e legjislacionit mbi përfitimet e përcaktuara në paragrafin 1.

3. Kjo Marrëveshje nuk zbatohet për ndihmën sociale apo për skemat e përfitimit për viktimat e luftës apo pasojat e saj.

4. Kjo Marrëveshje nuk zbatohet për legjislacionin që ofron një skemë të re të mbrojtjes shoqërore, përveçse kur autoritetet kompetente kanë rënë dakord ndryshe.

Neni 3

Fushëveprimi personal

Kjo Marrëveshje zbatohet për të gjithë personat të cilët janë ose kanë qenë subjekt i legjislacionit të secilit ose të dyja Shteteve Kontraktuese, si dhe për personat e tjerë të cilëve u lind e drejta nga këta persona.

Neni 4

Trajtimi i barabartë

Përveç kur parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje, personat e përcaktuar në nenin 3 do të kenë të njëjtat të drejta dhe detyrime siç përcaktohen në legjislacionin e Shtetit Kontraktues për

shtetasit e tij.

Neni 5
Eksporti i përfitimeve

1. Përveç kur parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje, të drejtat për përfitime dhe pagesat e përfitimeve në para sipas legjislacionit të njërit shtet kontraktues, nuk mund të reduktohen, ndryshohen, pezullohen ose konfiskohen për faktin se përfituesi banon në territorin e shtetit tjetër kontraktues.

2. Përfitimet e parashikuara në legjislacionin e secilit shtet kontraktues ose sipas kësaj Marrëveshjeje do t'i paguhen personit që banon në territorin e një shteti të tretë sikur të ishte shtetas i njërit prej Shteteve Kontraktues.

Neni 6
Shmangia e mbivendosjes së përfitimeve

Përveç kur parashikohet ndryshe, kjo Marrëveshje nuk mund të garantojë ose të ruajë të drejtën e dy ose më shumë përfitimeve të të njëjtit lloj që mbulojnë të njëjtin rrezik, për të njëjtën periudhë të sigurimit të detyrueshëm.

PJESA II
LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

Neni 7
Rregulli i përgjithshëm

Përveç kur parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje, një person që ushtron një aktivitet si i punësuar apo i vetëpunësuar në territorin e njërit prej Shteteve Kontraktuese, duhet që në lidhje me këtë aktivitet të jetë subjekt vetëm i legjislacionit të atij shteti kontraktues.

Neni 8
Punonjësit e dërguar me punë

1. Një person i punësuar normalisht në territorin e njërit prej Shteteve Kontraktuese, i cili dërgohet me punë nga punëdhënësi i tij/i saj në territorin e shtetit tjetër kontraktues për të kryer një punë të caktuar për atë punëdhënës, do të vazhdojë të jetë subjekt i legjislacionit të shtetit të parë kontraktues njëlloj sikur personi të ishte punësuar në territorin e tij, duke pasur parasysh që periudha e dërgimit me shërbim të mos i kalojë 24 muaj dhe që ai person nuk është dërguar për të zëvendësuar një person tjetër me shërbim, periudha e shërbimit të të cilit ka përfunduar. Me qëllim zbatimin e këtij paragrafi, punëdhënësi dhe një degë e shoqërisë ose ndihmëse e punëdhënësit, sipas përcaktimit të bërë nga ligjet e shtetit kontraktues nga i cili është dërguar personi, do të konsiderohen i njëjti person, duke marrë parasysh që punësimi në territorin e shtetit tjetër kontraktues do të mbulohej nga ligjet e shtetit kontraktues prej nga ku personi ishte dërguar, pavarësisht kësaj Marrëveshjeje.

2. Paragrafi 1 i këtij neni do të zbatohet kur një person i dërguar me punë nga punëdhënësi i tij/i saj nga territori i një shteti kontraktues në territorin e një shteti të tretë, i mbuluar me sigurim të detyrueshëm sipas ligjeve të atij shteti kontraktues, ndërsa është i punësuar në territorin e shtetit të tretë, dërgohet në vazhdim nga ai punëdhënës prej territorit të shtetit të tretë në territorin e shtetit tjetër kontraktues.

3. Një person i cili është normalisht i vetëpunësuar në territorin e njërit prej Shteteve Kontraktuese dhe që përkohësisht e transferon aktivitetin e tij të vetëpunësimit në territorin e shtetit tjetër kontraktues, do të jetë subjekt vetëm i ligjeve të shtetit të parë kontraktues, duke marrë parasysh që periudha e aktivitetit si i vetëpunësuar në territorin e shtetit tjetër kontraktues nuk kalon 12 muaj.

Neni 9
Personeli i sipërmarrjeve të transportit ndërkombëtar

1. Pavarësisht paragrafëve 2 dhe 3 të këtij neni, një person i punësuar nga një sipërmarrje transporti ndërkombëtar e cila e ka zyrën e saj të regjistrimit në territorin e një shteti kontraktues, do të jetë subjekt i legjislacionit të atij shteti kontraktues.

2. Një person i punësuar nga dega apo përfaqësia e përhershme e një sipërmarrjeje transporti ndërkombëtar do të jetë subjekt i legjislacionit të shtetit kontraktues në territorin e të cilit është vendosur dega apo përfaqësia.

3. Një person i punësuar në territorin e një shteti kontraktues ku ai/ajo banon do të jetë subjekt i legjislacionit të atij shteti kontraktues nëse sipërmarrja e transportit ndërkombëtar, e cila e ka punësuar atë nuk ka zyrë të regjistruar apo degë ose përfaqësi të përhershme në territorin e tij.

Neni 10

Anëtarët e ekuipazhit në anije

Një person, i cili kryen një aktivitet si i punësuar ose i vetëpunësuar në bordin e një anijeje që lundron nën flamurin e secilit prej Shteteve Kontraktuese, do të jetë subjekt i legjislacionit të atij shteti kontraktues.

Neni 11

Nëpunësit civilë

Nëpunësit civilë dhe personat e konsideruar të tillë do të jenë subjekt i legjislacionit të shtetit kontraktues në administratën e të cilit janë të punësuar.

Neni 12

Misionet diplomatike dhe zyrat konsullore

Anëtarët e misioneve diplomatike dhe zyrave konsullore, si dhe personeli privat i punësuar në shërbim të tyre do të jenë subjekt i dispozitave të caktuara nga Konventa e Vjenës mbi Marrëdhëniet Diplomatike, e datës 18 prill 1961 dhe Konventa e Vjenës mbi Marrëdhëniet Konsullore, e datës 24 prill 1963.

Neni 13

Përjashtimet nga dispozitat e neneve 7 dhe 12

Me kërkesë të përbashkët të të punësuarit dhe të punëdhënësit të tij ose me kërkesë të një të vetëpunësuari, autoritetet kompetente ose institucionet e përcaktuara të të dyja Shteteve Kontraktuese mund të bien dakord të bëjnë një përjashtim nga dispozitat e kësaj pjese, për sa u përket individëve ose kategorive të personave, duke marrë parasysh që çdo person do të jetë subjekt i legjislacionit të njërit shtet kontraktues.

PJESA III

DISPOZITA TË VEÇANTA NË LIDHJE ME KATEGORITË E NDRYSHME TË PËRFITIMIT

SEKSIONI 1

PËRFITIMET E SËMUNDJEVE DHE BARRËLINDJEVE

Neni 14

Bashkimi i periudhave të sigurimit

Nëse legjislacioni i shtetit tjetër kontraktues jep të drejtën për përfitime të kushtëzuara në varësi të përmbushjes së periudhës së sigurimit, institucioni kompetent i këtij shteti duhet të marrë në konsideratë, nëse është e nevojshme, periudhat e sigurimit të përmbushura sipas legjislacionit të shtetit tjetër kontraktues, me kusht që ato të mos mbivendosen, sikur të ishin periudha sigurimi të përmbushura sipas legjislacionit të shtetit të parë kontraktues.

Neni 15

Dhënia e përfitimeve

1. Një person i cili ka kërkuar të drejtën e përfitimeve nën legjislacionin e një shteti kontraktues do të marrë në territorin e shtetit tjetër kontraktues:

a) Përfitime në natyrë nga institucioni i shtetit tjetër kontraktues në bazë të legjislacionit të tij, sikur ai/ajo të jetë i siguruar atje, por vetëm në masën e nevojshme, nëse kushtet shëndetësore të personit në fjalë kërkojnë dhënien e menjëhershme të këtyre përfitimeve;

b) Përfitime në para, drejtpërdrejt nga institucioni kompetent i shtetit të parë kontraktues, në bazë të legjislacionit të tij.

2. Përfitimet në natyrë do të jepen në territorin e shtetit tjetër kontraktues edhe përtej masës së nevojshme të parashikuar në paragrafin 1, me pëlqimin e institucionit kompetent të shtetit të parë kontraktues.

Neni 16

Sigurimi shëndetësor i pensionistëve

Personat të cilët marrin pension nga të dyja shtetet kontraktuese do të jenë subjekt i legjislacionit për sigurimin shëndetësor dhe do të kenë të drejtën për përfitime në natyrë nga shteti kontraktues në territorin e të cilit banojnë.

Neni 17

Rimbursimi i shpenzimeve të përfitimeve në natyrë

1. Institucioni kompetent i një shteti kontraktues do t'i rimbursojë institucionit të shtetit tjetër kontraktues shpenzimet e përfitimeve të dhëna sipas nenit 15, për secilin rast, duke përjashtuar shpenzimet administrative.

2. Shuma e shpenzimeve e pretenduar për rimbursim nga institucioni kompetent vendoset nga institucioni i cili ka dhënë përfitimet, me çmimet që zbatohen për dhënien e përfitimeve për të siguruarit e tij.

3. Autoritetet kompetente do të bien dakord për aspektet teknike të dhënies së përfitimeve dhe mënyrën detyruese të rimbursimit të shpenzimeve mes institucioneve të Shteteve Kontraktuese. Me qëllimin për të thjeshtësuar procedurat administrative, ata mund të bien dakord që për të gjitha rastet, ose për një grup të caktuar rastesh, do të përdoret një shumë fikse në vend të rimbursimit individual për secilin rast konkret.

SEKSIONI 2

PËRFITIMET PËR PENSION, PENSION INVALIDITETI DHE PENSION FAMILJAR

Neni 18

Bashkimi i periudhave të sigurimit

1. Nëse legjislacioni i njërit shtet kontraktues kryen marrjen, ruajtjen ose rikuperimin e një të drejte për përfitim në varësi të ekzistencës apo përmbushjes së periudhave të caktuara të sigurimit, institucioni kompetent i këtij shteti kontraktues do të marrë parasysh ekzistencën e sigurimit apo periudhat e barasvlershme të sigurimit të përmbushura sipas legjislacionit të shtetit tjetër kontraktues, në masën që ato nuk mbivendosen, sikur të ishin sigurime të përmbushura sipas legjislacionit të tij.

2. Institucioni i secilit shtet kontraktues merr në konsideratë, gjithashtu, periudha të sigurimit të plotësuara nën legjislacionin e një shteti të tretë me të cilin ai shtet kontraktues është lidhur me anë të një instrumenti sigurimesh shoqërore, i cili parashikon bashkimin e periudhave.

Neni 19

Llogaritja e përfitimeve

1. Institucioni kompetent i shtetit kontraktues do të llogarisë shumën e përfitimit që do të jetë:

a) sipas legjislacionit që zbaton, kur kushtet për të drejtën e përfitimeve të jenë përmbushur në bazë të periudhave të sigurimit të plotësuara ekskluzivisht sipas legjislacionit të tij;

dhe

b) sipas rregullave të parashikuara nga paragrafi 2, me përjashtim kur rezultati i kësaj llogaritjeje është i barabartë ose më i ulët se rezultati i llogaritjes, sipas pikës 1, nënparagrafi "a".

2. Institucioni kompetent i shtetit kontraktues do të vendosë shumën e përfitimit duke marrë në konsideratë periudhat e sigurimit, të plotësuara nën legjislacionin e shtetit tjetër kontraktues ose një shteti të tretë, brenda kuptimit të nenit 18, si vijon:

a) llogaritet shuma teorike e përfitimit që do të ishte kërkuar, nëse të gjitha periudhat e sigurimit do të ishin përmbushur sipas legjislacionin të tij; dhe

b) më pas, mbi bazën e shumës teorike të llogaritur sipas nënparagrafit "a", përcaktohet shuma e përfitimit të pagueshëm duke aplikuar raportin e kohëzgjatjes së periudhave të sigurimit të përmbushura sipas legjislacionit të tij me periudhën totale të sigurimit.

Në mënyrë që të përcaktohet baza për llogaritjen e përfitimit, institucioni kompetent do të marrë parasysh të ardhurat e fituara vetëm gjatë periudhave të sigurimit të kryera nën legjislacionin e zbatueshëm. Ky institucion duhet të marrë parasysh këto të ardhura – të indeksuara dhe mesatare nëse supozohet nga legjislacioni në fuqi – siç janë fituar gjatë periudhave të sigurimit që janë marrë parasysh për llogaritjen e shumës teorike të përfitimit.

3. Personi në fjalë do të ketë shumën më të lartë të llogaritur në përputhje me paragrafët 1 dhe 2.

Neni 20

Periudhat e sigurimit më pak se një vit

1. Pavarësisht dispozitave të parashikuara të nenit 18, nëse kohëzgjatja e përgjithshme e periudhave të sigurimit të përmbushura sipas legjislacionit të shtetit kontraktues është më pak se një vit dhe nëse, vetëm në bazë të këtyre periudhave, nuk ekziston në bazë të legjislacionit asnjë e drejtë për përfitime, institucioni i atij shteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të japë përfitime në lidhje me këto periudha.

2. Periudhat e sigurimit, të referuara në paragrafin 1, do të merren parasysh nga institucioni i shtetit tjetër kontraktues, sikur këto periudha të ishin përmbushur sipas legjislacionit që ai zbaton.

Neni 21

Asimilimi i fakteve

1. Ngjarjet që kanë efekt juridik mbi të drejtën për përfitim, zvogëlimin, pezullimin ose shumën e përfitimeve dhe të cilat kanë ndodhur në territorin e shtetit tjetër kontraktues, do të merren parasysh në të njëjtën mënyrë sikur të kishin ndodhur në territorin e shtetit të parë kontraktues.

2. Autoriteti kompetent i secilit shtet kontraktues, në interes të kategorive të përfituesve, mund të kufizojë zbatimin e parashikimit të paragrafit 1.

Neni 22

Dispozita të veçanta në lidhje me Republikën Çeke

Një person me aftësi të kufizuar, aftësia e kufizuar e të cilit ka filluar para se ai/ajo të arrinte moshën 18 vjeç dhe që nuk ka marrë pjesë në skemën e sigurimeve për periudhën e nevojshme, do të ketë të drejtë për një përfitim të invaliditetit, me kusht që ky person të ketë vendbanimin në Republikën Çeke.

SEKSIONI 3

PËRFITIMET PËR AKSIDENTET NË PUNË DHE NGA SËMUNDJET PROFESIONALE

Neni 23

Dhënia e përfitimeve në para

1. Përfitimet për aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale do të jepen nga institucioni kompetent i shtetit kontraktues për të cilin legjislacioni i të cilit zbatohej për personin në momentin kur ka ndodhur aksidenti në punë ose periudha kur personi ka qenë i angazhuar në një profesion që shkakton sëmundje profesionale.

2. Nëse legjislacioni i njërit prej shteteve kontraktuese e lidh dhënien e përfitimeve me kushtin që sëmundja në fjalë diagnostikohet fillimisht në territorin e tij, ky kusht do të konsiderohet i përmbushur nëse sëmundja është diagnostikuar për herë të parë në territorin e shtetit tjetër kontraktues.

3. Nëse legjislacioni i secilit shtet kontraktues e lidh dhënien e përfitimeve me kushtin që një profesion që mund të shkaktojë sëmundje profesionale të ushtrohet për një periudhë të caktuar, do të merret parasysh çdo periudhë e një profesioni të ngjashëm e ushtruar në përputhje me legjislacionin e shtetit tjetër kontraktues.

Neni 24

Përfitimet në natyrë

Përfitimet në natyrë do të parashikohen dhe rimbursohen në bazë të pjesës së tretë – seksioni 1 i kësaj Marrëveshjeje.

Neni 25

Dhënia e përfitimeve në para për përkeqësimin e një sëmundje profesionale

Nëse një person ka marrë ose është duke marrë përfitime për një sëmundje profesionale nga një institucion kompetent i njërit prej Shteteve Kontraktuese dhe pretendon përfitime në rastin e përkeqësimit të sëmundjes së tij të shkaktuar nga angazhimi profesional në territorin e shtetit tjetër kontraktues, do të zbatohen dispozitat e mëposhtme:

a) Përfitimet jepen nga institucioni i shtetit të parë kontraktues sipas legjislacionit të tij, pa marrë parasysh përkeqësimin e sëmundjes;

b) Institucioni i shtetit tjetër kontraktues do të japë përfitimin në një shumë të barabartë me diferencën midis shumës së përfitimit të caktuar pas përkeqësimit dhe shumës së përfitimit që do të ishte dhënë para përkeqësimit, sipas legjislacionit të zbatueshëm.

PJESA IV

DISPOZITA TË NDRYSHME

Neni 26

Masat administrative dhe të bashkëpunimit

1. Autoritetet kompetente të të dyja Shteteve Kontraktuese do të rregullojnë dhe përcaktojnë masat e nevojshme për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

2. Autoritetet kompetente:

a) do të bien dakord sipas Marrëveshjes Administrative për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje;

b) do të informojnë reciprokisht njëri-tjetrin rreth ndryshimeve në legjislacionin e Shteteve Kontraktuese;

c) do të krijojnë organe ndërlidhëse, me qëllim thjeshtimin e komunikimit ndërmjet institucioneve të Shteteve Kontraktuese.

3. Autoritetet dhe institucionet kompetente të të dyja Shteteve Kontraktuese do të ndihmojnë njëri-tjetrin për çdo çështje në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje njëlloj sikur çështja të cenojë zbatimin e legjislacionit të tyre. Një asistencë e tillë do të jetë falas.

4. Nëse një person që banon ose qëndron në secilin shtet kontraktues pretendon ose është duke marrë përfitime sipas legjislacionit të shtetit tjetër kontraktues dhe është i nevojshëm një kontroll shëndetësor, institucioni i vendit të banimit ose qëndrimit i shtetit të parë kontraktues do të marrë masa për kontrollin shëndetësor me shpenzimet e tij, me kërkesë të institucionit kompetent të shtetit

tjetër kontraktues.

Neni 27

Përdorimi i gjuhëve zyrtare

1. Për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, autoritetet dhe institucionet e Shteteve Kontraktuese mund të komunikojnë drejtpërdrejt në gjuhët e tyre zyrtare dhe, gjithashtu, në anglisht.

2. Asnjë kërkesë ose dokument nuk do të refuzohet me arsyen së është hartuar në gjuhën zyrtare të shtetit tjetër kontraktues.

Neni 28

Përjashtimet nga detyrimet dhe vërtetimet

1. Nëse legjislacioni i secilit shtet kontraktues parashikon përjashtime, plotësisht ose pjesërisht, nga ndonjë shpenzim gjyqësor, taksat konsullore ose detyrimet administrative, përjashtime të tilla do të zbatohen për çdo dokument të paraqitur sipas legjislacionit të shtetit tjetër kontraktues për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

2. Të gjitha deklarimet, dokumentet dhe certifikatat e çdo lloji të kërkuara për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të përjashtohen nga vërtetimi i autoriteteve diplomatike dhe konsullore.

3. Kopje të dokumenteve të cilat janë të certifikuara dhe kopjet e sakta nga një institucion i njërit shtet kontraktues do të pranohen nga institucioni i shtetit tjetër kontraktues pa certifikim të mëtejshëm.

Neni 29

Dorëzimi i kërkesës ose ankesës

Çdo kërkesë ose ankesë e cila, sipas legjislacionit të secilit shtet kontraktues, duhet t'i paraqitet autoritetit ose institucionit kompetent të atij shteti kontraktues brenda një periudhe të parashikuar, do të trajtohet sikur të ishte paraqitur brenda së njëjtës periudhë autoritetit ose institucionit përkatës të shtetit tjetër kontraktues. Në raste të tilla, autoriteti ose institucioni kompetent i shtetit kontraktues, i cili merr kërkesën ose ankesën, ia kalon atë menjëherë pa vonesë autoritetit ose institucionit të shtetit të parë kontraktues, drejtpërdrejt ose nëpërmjet organeve ndërlidhëse të të dyja Shteteve Kontraktuese.

Neni 30

Kthimi i pagesave të vonuara

Nëse institucioni i shtetit kontraktues i ka paguar përfitime në mënyrë të padrejtë ose në një shumë më të lartë një personi, brenda afateve dhe kufijve të përcaktuar në legjislacionin qe ai zbaton, i kërkon institucionit të shtetit tjetër kontraktues përgjegjës për pagesën e përfitimeve personit të interesuar, që të zbresë shumën e tepërt ose të padrejtë të parave prej pagesave në vazhdim ose të prapambetura që i detyrohet personit në fjalë. Institucioni i shtetit tjetër kontraktues do të zbresë shumën në fjalë në bazë të kushteve dhe kufizimeve në përputhje me legjislacionin që ai zbaton në të njëjtën mënyrë si të kishte bërë vetë mbipagesën dhe do t'ia transferojë shumën e zbritur institucionit që ka paguar përfitimet padrejtësisht apo më tepër.

Neni 31

Procedura të detyrueshme

1. Vendimet e detyrueshme të gjykatave të secilit prej Shteteve Kontraktuese, si dhe dokumentacioni i detyrueshëm i lëshuar nga autoritetet ose institucionet e secilit prej Shteteve Kontraktuese, do të njihen në territorin e shtetit tjetër kontraktues në përputhje me kontributet e sigurimit shoqëror dhe detyrime të tjera.

2. Njohja mund të refuzohet vetëm në rastet kur nuk përputhet me rendin publik të shtetit

kontraktues në territorin e të cilit njohja e vendimit apo e dokumentit është e detyrueshme.

3. Vendimet e detyrueshme dhe dokumen-tacioni i njohur sipas paragrafit 1 të këtij neni do të hyjnë në fuqi në territorin e shtetit tjetër kontraktues. Procedura e hyrjes në fuqi do të kryhet në përputhje me legjislacionin që vendos për hyrjen në fuqi të vendimeve dhe dokumenteve të tilla të shtetit kontraktues në territorin e të cilit vendoset që të hyjë në fuqi.

4. Çdo lloj detyrimi që i përket institucionit të secilit shtetit kontraktues, në çdo procedurë falimentimi ose vendosje për hyrje në fuqi në territorin e shtetit tjetër kontraktues, do të ketë të njëjtin prioritet si pretendimet e barasvlershme në territorin e atij shteti kontraktues.

Neni 32

Monedha e pagesës

Pagesat në shtetin tjetër kontraktues që rezultojnë nga zbatimi i kësaj Marrëveshjeje do të bëhen në monedhë të konvertueshme.

Procedura e pagesave dhe kursit të këmbimit do të përcaktohet hollësisht në Marrëveshjen Administrative.

Çdo kontroll i monedhës së një shteti kontraktues nuk do të ndërhyjë te transferimi i fondeve që rezultojnë nga zbatimi i kësaj Marrë-veshjeje.

Neni 33

Konfidencialiteti i informacionit të shkëmbyer

Përveç kur kërkohet ndryshe nga legjislacionet kombëtare të Shteteve Kontraktuese, informacioni për një individ, i cili transmetohet nga një shtet kontraktues shtetit tjetër kontraktues në përputhje me këtë Marrëveshje, do të përdoret ekskluzivisht për qëllimet e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje. Ky informacion i marrë nga shteti kontraktues do të udhëhiqet nga ligjet kombëtare të atij Shteti Kontraktues, me qëllim ruajtjen e privatësisë dhe konfidencialitetit të të dhënave personale .

Neni 34

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që lidhet me interpretimin apo zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet me konsultime ndërmjet autoriteteve ose institu-cioneve kompetente të Shteteve Kontraktuese.

PJESA V

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE DHE KALIMTARE

Neni 35

Dispozita kalimtare

1. Kjo Marrëveshje nuk do të ketë asnjë të drejtë për periudhën para hyrjes së saj në fuqi.

2. Të gjitha periudhat e sigurimit të përmbushura sipas legjislacionit të shtetit kontraktues para hyrjes në fuqi të kësaj Marrë-veshjeje do të merren parasysh për qëllimin e përcaktimit të të drejtave që lindin nga kjo Marrëveshje.

3. Në bazë të paragrafit 1 të këtij neni, të drejta mund të lindin nga Marrëveshja edhe në lidhje me ndonjë rast i cili mund të ketë lindur para se kjo Marrëveshje të hynte në fuqi, përveç shumës fikse.

4. Të drejtat e personave të cilët kanë përfituar pension para se kjo Marrëveshje të hynte në fuqi, me kërkesë të personave të interesuar, do të rishikohen sipas dispozitave të kësaj Marrëveshje. Ky rishikim nuk do të sjellë reduktim të të drejtave ekzistuese të përfituesve.

5. Në rastet kur kërkesa për përfitim ose rishikimi i saj sipas këtij neni paraqiten brenda dy vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, të drejtat e përfituara në përputhje me këtë Marrëveshje do të kenë fuqi nga ajo datë dhe ndaj personit të interesuar mund të mos zbatohet legjislacioni i shtetit kontraktues në lidhje me humbjen ose kufizimin e të drejtave ndaj personave të interesuar.

Neni 36

Ratifikimi dhe hyrja në fuqi

1. Kjo Marrëveshje është subjekt ratifikimi.

2. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit të tretë kalendarik pas muajit në të cilin Shtetet Kontraktuese informojnë njëri-tjetrin me shkrim, se janë përmbushur të gjitha kërkesat ligjore dhe kushtetuese për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 37

Kohëzgjatja dhe përfundimi i Marrëveshjes

1. Kjo Marrëveshje lidhet për një kohë të papërcaktuar.

2. Secili prej Shteteve Kontraktuese mund ta përfundojë këtë Marrëveshje nëpërmjet një njoftimi me shkrim për shtetin tjetër kontraktues. Në këtë rast, kjo Marrëveshje do të pushojë së qeni e vlefshme ditën e parë të muajit të gjashtë kalendarik pas muajit kur i është dërguar njoftimi me shkrim shtetit tjetër kontraktues.

3. Në rast të përfundimit të kësaj Marrëveshjeje, do të ruhen të gjitha të drejtat e fituara sipas dispozitave të saj dhe të gjitha ankesat e paraqitura para fundit të vlefshmërisë së kësaj Marrëveshje do të zgjidhen sipas dispozitave të saj. Shtetet Kontraktuese do të hartojnë një rregullore për procedurat të cilat lidhen me këto të drejta.

Në dëshmi të kësaj, duke qenë rregullisht të autorizuar për këtë qëllim nënshkruesit kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Nënshkruar në Pragë, më 13.10.2015, në dy kopje origjinale, secila në gjuhën shqipe, çeke dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëlloj autentike. Në rast mospërputhjesh në përkthim, versioni në gjuhën angleze do të ketë përparësi.